
MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
NJOFTIM PËR DHËNIE ME QIRA

BASHKIA DEVOLL
NJOFTIM PËR DHËNIE ME QIRA

1. Autoriteti: BASHKIA DEVOLL.

Adresa : Bashkia Devoll, Lagja nr.1, Rr. 24 Tetori nr.9,

2.Dhënia me qira e sipërfaqeve nga fondi kullor me konkurim publik në pronësi të Bashkisë Devoll,Zona Kadastrale 3750, Numri i Pasurisë 1443 ne ngastren 17 dhe Numri i Pasurisë 1445 në ngastrën 18 me sipërfaqe totale 1,018,971 m² ose 101.89 ha.Zona Kadastrale 3804, Numri i Pasurisë 1728 në ngastrën 7 me sipërfaqe totale 929,717 m² ose 92.97 ha të cilat

bëjnë pjesë në Ekonominë Kullorë “Bilisht” në pronësi të Bashkisë Devoll me sipërfaqe totale 1,948,688 m² ose 194.86 ha.

3.Qëllimi i dhënies me qira të fondit kullor me konkurim publik në pronësi të Bashkisë Devoll, është dhënia në përdorim e sipërfaqes prej 194. 86 ha të Pasurive me Numër 1443 dhe 1445 në Zonën Kadastrale 3750 dhe Pasuria me Numër 1728 në Zonën Kadastrale 3804 për zhvillimin ekonomik me destinacion për ndërtim teleferik pasagjerësh ose linjë të tensionit, aerogjeneratorë dhe fotovoltaike.

4.Konkurrimi do të zhvillohet më datë 18.07.2024 ora 12:00 në Sallën e Këshillit Bashkiak, Bashkia Devoll.

5.Çmimi dysheme i qirasë, është: Kullotë: 176,000 (Njëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë) lekë/ha në vit e përlogaritur sipas VKM nr.559, datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar,për veprimtari ekonomike,si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore Pyjore”.

6.Afati i dhënies me qira të kësaj pasurie do të jetë 10 (dhjetë) vjet nga momenti i nënshkrimit të kontratës me të drejtë rinovimi.

7.Kushtet e pjesëmarrjes në konkurim janë:

- a) Garanci financiare e mjaftueshme për përballimin e investimit të parashikuar në plan biznes.
- b) Të ketë të kontraktuar një specialist të fushës ,ku në CV – në profesionale të tregohet përvoja në fushën e veprimtarisë.
- c) Vërtetim nga organet përkatëse shtetërore se subjekti nuk ka procese gjyqësore në ngarkim,hetim në proces,detyrime tatimore ose detyrime të tjera ndaj të tretëve,
- d) Vërtetim për shlyerjen e taksave,tarifave dhe detyrimeve vendore për vitin 2024

8.Ofertuesit janë të lutur të paraqesin vetëm një ofertë, në datën dhe orën e caktuar, dhe dokumentacionin si vijon :

- a) Kërkesë së bashku me të dhënat për sipërfaqen e kërkuar dhe gjeneralitetet e tyre;
- b) Çertifikatën e regjistrimit dhe Ekstraktin e regjistrimit në QKB për objektin e veprimtarisë,
- c) Projektin teknik të hartuar nga specialistë të licensuar ku janë trajtuar të gjithë elementët e nevojshëm për zhvillimin e veprimtarisë së kërkuar,(i cili përmban hartën topografike me kordinatat e sipërfaqes objekt përdorimi në variantin PDF dhe në format elektronik në shkallë 1:10.000, ku të jenë evidentuar elementët kryesorë,si kufijtë natyrorë,relievi, objektet aktuale, si dhe çdo planimetri tjetër në shkallë më të detajuar,hartuar konform kërkesave të projektit);
- d) Planbiznesin dhe investimet që do të bëhen;
- e) Të dhënat për kapacitetet teknike,stafin makineritë dhe paisjet që zotëron;
- f) Planin e rehabilitimit të sipërfaqes dhe kthimin e saj në gjendjen e mëparshme;
- g) Nivelin e punësimit në veprimtari;
- h) Raportin e vlersimit të ndikimit mjedis nga ekspertë të çertifikuar;
- i) Çmimin e qerasë së ofruar për ha/vit;

- j) Afati i qirasë.
- k) Adresës e subjektit, telefonin, e-mail dhe faks.

Deklaratë se mban përgjegjësi ligjore për vërtetësinë e deklarimeve në dokumentacionin e dorëzuar në konkurrim. Në rast konstatimi të të dhënave të rreme, në cdo rast, Komisioni e skualifikon subjektin konkurrues.

9. Oferta paraqitet në një zarf të mbyllur i cili duhet të përmbajë një kopje origjinale ose të noterizuar të dokumentacionit të ofertës dhe ku të përcaktohen qartë identiteti dhe adresa e personit, fizik apo juridik të interesuar dhe të dorëzohen në zyrën e Protokollit të Bashkisë Devoll, para orarit të hapjes së ofertave.

10. Sigurimi i ofertës.

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Formularin e Sigurimit të Ofertës,
Shuma e kërkuar e sigurimit të ofertës duhet të jetë sa 2% e vlerës së ofertës

Llogaritja bëhet: Vlera e qirasë X ha X vitet e qirasë X 2%

11. Vlerësimi i ofertave do të bëhet sipas pikëve për kriteret e përcaktuara si më poshtë:

- a) Projekti teknik i veprimtarisë që do të ushtrohet, (i cili përmban hartën topografike me koordinatat e sipërfaqes objekt përdorimi në variantin PDF dhe në format elektronik në shkallë 1:10.000, ku të jenë evidentuar elementët kryesorë, si kufijtë natyrorë, relievi, objektet aktuale, si dhe çdo planimetri tjetër në shkallë më të detajuar, hartuar konform kërkesave të projektit)..... 20 pikë.
- b) Plani i biznesit dhe investimet që do të bëhen 15 pikë.
- c) Planin e rehabilitimit të sipërfaqes..... 25 pikë.
- d) Nivelin e punësimit në veprimtari..... 5 pikë.
- e) Masën e qerasë për ha/vit 35 pikë.

12. Informacion mbi dokumentet e konkurimit publik:

Dokumentet e ankandit mund të tërhiqen pranë autoritetit të dhënies me qera Bashkia Devoll.

Dokumente me pagesë: Po X Jo

Nëse Po Monedha _____ Çmimi 1000 Leke

Dokumentet standarde të ankandit përbehen nga:

- Formulari i njoftimit;
- Kërkesa për pjesëmarrje;
- Formulari i ofertës;
- Ftesa për oferte;
- Formulari i njoftimit të fituesit;
- Formulari i publikimit të njoftimit të fituesit;
- Procesverbali/et i/e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.